



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2024:036527

Datë: 27.09.2024

Numri i dokumentit: 06220123

C.nr. 703/2024

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, sipas gjyqtarit Raif Fazliu, në çështjen juridiko-civile të paditëses Q.M.nga fshati S., Komuna e Vitisë, kundër të paditurës Komuna e Vitisë, Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) në Viti, për anulimin e konkursit publik, jashtë seancës gjyqësore, më 27.09.2024, nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. KONSTATOHET** e tërhequr padia e ushtruar më datë 30.01.2024, e paditëses Q.M., nga S.e Komunës së Vitisë. kundër të paditurës Komuna e Vitisë - Drejtoria Komunale e Arsimit në Viti, për anulimin e konkursit publik nr. 02-111/01-1350 të datës 09.11.2023.

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

**A r s y e t i m**

Paditësja, Q.M., nga S.e Komunës së Vitisë, vetë personalisht, me datë 30.01.2024, ka paraqitur dhe dorëzuar në gjykatë padi për prishjen e zgjedhjes sipas konkursit nr. 02-111/01-1350 të datës 09.11.2023. për themelimin e marrëdhënies së punës për pozitën mësimdhënëse për lëndën në gjuhën angleze, në Shkollën e Mesme Teknike – IAAP “J.Z.” në Viti.

Gjykata ka mbajtur seancën përgatitore me datë 04.04.2024, por me propozimin e paditëses Q.M., gjykata e ka ndërprerë shqyrtimin e lëndës konkrete, pasi që palët në seancë kanë shprehur gatishmëri që paditëses ti vazhdohet kontrata e punës me kohë të caktuar, me mundësi të pranimit dhe themelimit të marrëdhënies së punës me kohë të pa caktuar.

Më datën 26.09.2024 paditësja vetë personalisht, në gjykatë ka dorëzuar parashtresën me të cilën e njofton gjykatën se e tërheq padinë, të dorëzuar me datë 30.01.2024, duke e arsyetuar tërheqjen se me të paditurën Komunën e Vitisë ka lidhur dhe nënshkruar kontratën e punës për mësimdhënëse me kohë të caktuar për vitin shkollor 2024/25.

Gjykata e respekton propozimin e palës paditëse, palë aktive, andaj edhe konstaton se tërhiqet padia.

Me qenë se pala aktive në procedurë e ka tërhequr padinë, gjykata në kuptim të nenit 261, paragrafët 2, 3 dhe 4 të LPK-së, bie aktvendim me të cilin konstatohet e tërhequr padia e paditëses.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË VITI

C.nr.703/2024

Më:27.09.2024

G j y q t a r i  
Raif Fazliu

**KËSHILLË JURIDIKE:** kundër këtij aktvendimi ankesa nuk është e lejuar, në kuptim të nenit 261.4 të LPK-së.